

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 nga Rregullorja e punës ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.66/2013 dhe 114/2014) dhe neni 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV"14/2022), duke vepruar mbi konkluzionin e sektorëve civil të katër gjykatave të apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për shqyrtimin e çështjes juridike për sigurimin e unifikimit në zbatimin e ligjit dhe harmonizimin e praktikës gjyqësore, në seancën e mbajtur më 21.03.2023, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

I.

Kompensimi i dëmit për shkak të privimit pabazë nga liria

Personi që ka qenë në paraburgim ose vuajtje të dënimit, privim nga liria, në qoftë se procedura është ndërprerë me aktvendim të plotfuqishëm për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, ka të drejtë për kompensim dëmi, përveç nëse me procedurat e tij të palejuara do të shkaktonte privimin nga liria.

II.

Kompensimi i dëmit për shkak të dënimit të pabazuar

Personi i akuzuar me aktgjykim të plotfuqishëm kundër të cilit me rastin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik akuza i është refuzuar, i takon kompensim të dëmit pa marrë parasysh që nuk ka qenë i privuar nga liria, përveç nëse me pranim të rrejshëm ose me ndonjë mënyrë tjetër me qëllim e ka shkaktuar dënimin.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Sektori i veprave civile është dorëzuar Konkluzion i katër gjykatave të apelit të nxjerrë në takimin e punës, të mbajtur më 08-09.06.2022, për unifikimin e praktikës gjyqësore për çështje juridike, a i takon kompensim të dëmit një personi që ka qenë në paraburgim nëse procedura është ndërprerë për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale në kuptim të nenit 553 të Ligjit për procedurë penale (në kushte kur ai vet nuk ka kryer veprime të palejuara që të jetë i privuar nga liria), dhe A i takon kompensim të dëmit një personi të akuzuar me aktgjykim të plotfuqishëm sipas të cilit me mjetin e jashtëzakonshëm akuza i është refuzuar, në qoftë se nuk ka qenë i privuar nga liria ose nuk ka filluar me vuajtjen e dënimit me burgim nga ai aktgjykim.

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke shqyrtuar mbi çështjen e parashtruar juridike e miraton mendimin juridik, për shkaqet si në vazhdim:

Në përputhje me nenin 549 paragrafi (1) të Ligjit për procedurë penale, të drejtë kompensimi për shkak të dënimit të paarsyeshëm, ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksion penal i plotfuqishëm ose i cili është shpallur fajtor e është liruar nga dënimi, kurse më vonë pas mjetit të jashtëzakonshëm juridik procedura e re është ndërprerë në mënyrë të plotfuqishme ose me aktgjykim të plotfuqishëm është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, vetëm në rastet nëse:

1) deri në ndërprerjen e procedurës ose aktgjykimit me të cilin akuza refuzohet ka ardhur për shkak se në procedurën e re paditësi privat ka heq dorë nga ndjekja, ose i dëmtuari ka

heq dorë nga propozimi e në heqjen dorë ka ardhur në bazë të marrëveshjes me të akuzuarin dhe 2) me aktvendim në procedurën e re aktakuza është hedhur poshtë për shkak se gjykata nuk ka qenë kompetente, ndërsa paditësi i autorizuar e ka filluar ndjekjen para gjykatës kompetente.

Sipas paragrafit (2), i akuzuari nuk ka të drejtë kompensimi të dëmit nëse me pranimin e tij të rrejshëm ose në mënyrë tjetër me qëllim e ka shkaktuar dënimin e vet, përveç nëse në atë ka qenë i detyruar.

Sipas nenit 553 paragrafi (1), pika 1 të Ligjit për procedurë penale, të drejtë për kompensim të dëmit i takon edhe personit: i cili ka qenë në paraburgim e nuk ka ardhur deri në ngritjen e procedurës penale ose procedura është ndërprerë me aktvendim të plotfuqishëm, ose me aktgjykim të plotfuqishëm është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar.

Sipas paragrafit (3) nga e njëjta dispozitë, kompensim të dëmit nuk i takon personit i cili me veprimet e tija të palejuara ka shkaktuar privim nga liria. Në rastet nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni përjashtohet e drejta e kompensimit të dëmit edhe pse kanë ekzistuar rrethanat nga neni 549 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, ose nëse procedura është ndërprerë në bazë të nenit 304 të këtij ligji.

Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të theksuara të Ligjit për procedurë penale, pa diskutim mund të arrihet në konkluzion se në rastin e ndërprerjes së procedurës penale me vendimin e plotfuqishëm për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, personi i privuar nga liria ka të drejtë të kompensimit të dëmit sipas nenit 553 paragrafi (1), pika 1 të Ligjit për procedurë penale, në qoftë se nuk ekzistojnë rrethana për përjashtimin e të drejtës së tillë të përcaktuar në paragrafin (3) nga e njëjta dispozitë. Të drejtë të këtillë i takon edhe personit për shkak të dënimit të paarsyeshëm sipas nenit 549 paragrafi (1), pika 1 të Ligjit për procedurë penale, në qoftë se me rastin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik aktakuza është refuzuar pa marrë parasysh atë se nuk ka qenë i privuar nga liria, përveç nëse nuk ekzistojnë rrethana për përjashtimin nga e drejta e kompensimit të dëmit të përcaktuar në nenin 549 paragrafi (2) dhe nenin 553 paragrafi (3) të Ligjit për procedurë penal, për shkak që e drejta e kompensimit të dëmit varet nga rrjedhja përfundimtare e procedurës penale që është edhe në përputhje me nenin 5 paragrafi (5) nga Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Gjithsesi, ai që thërritet në rrethana të përcaktuara në nenin 549 paragrafi (2) të Ligjit për procedurë penale sipas të cilave nuk përfshihet e drejta për kompensimin e dëmit, përkatësisht është shkurtuar e drejta e tillë, është i detyrueshëm të propozojë dëshmi në përputhje me nenin 205 paragrafi (1) të Ligjit për procedurë kontestimore përkatësisht në te ai bie ngarkesa e dëshmimit.

GJYKATA SUPREME
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Sektori i veprave civile